

NJOFTIM PUBLIK

Në bazë të pikës 3/1 të VKM Nr. 589, datë 10.09.2014 "Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale" i ndryshuar;

NJOFTOJMË:

- I. Të gjithë subjektet që kanë ndërtuar objekte pa leje apo shtesa pa leje në objekte me leje, kanë mundësinë të plotësojnë deklaratën për përfshirje në procesin e legalizimit për objektin informal të ndërtuar, por **të padëklaruar asnjëherë më parë.**
- II. Subjektet që do të plotësojnë aplikimet e reja për përfshirje në procesin e legalizimit **bashkë më deklaratën** duhet të dorëzojnë edhe dokumentat si më poshtë:
 - 1- Certifikatë të gjendjes familjare.
 - 2- 4 fotografi të objektit.
 - 3- Kopje të noterizuar të dokumentit të pronësisë së truallit ku është ndërtuar objekti pa leje/shtesa pa leje në objekt me leje, *nëse ka.*
 - 4- Leje ndërtimi dhe Leje shesh ndërtimi për shtesat pa leje në objekt me leje, *nëse ka.*
 - 5- Kopje të dokumentit të identifikimit (karte ID ose pasaportë)
- III. Pranimi i deklaratave për përfshirje në procesin e legalizimit do të bëhet **vetëm për objektet e ndërtuara deri në datën 27.06.2014.**
- IV. Për ndërtimet informale, të ngritura brenda zonave dhe nënzonave të mbrojtura si dhe zonave të ruajtjes së veçantë, ku shkalla e mbrojtjes nuk ndalon ndërtimet me funksion banimi ose social/ekonomik, procedurat e kualifikimit kryhen pas depozitimit, nga poseduesi i ndërtimit, të aktit për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM), nga një ent apo subjekti i licencuar, **pasi të jetë kryer verifikimi në terren i objektit pa leje/shtesës pa leje nga ALUIZNI.**

DREJTORI
EGON VELA

